



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 62 prot.

Kamëz, më 25.8.2025

V E N D I M
Nr. 53 .Datë 25/8 2025

MBI

**“DHËNIE PËLQIMI PËR PËRCAKTIMIN E PASURISË ME NR. 42/26, ZONË
KADASTRALE 2066, NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ PËR NDËRTIMIN E
BANESAVE SOCIALE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.08.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.49 Datë 23.07.2025 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës; Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar; Ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”; VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”; VKM-së nr. 325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”; Urdhrit nr. 1052, datë 02.12.2024 “Për miratimin e mesatares së çmimeve të shitjes së banesave në treg, sipas zonave kadastrale, për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin për dhënien e pëlqimit për përcaktimin e pasurisë me nr. 42/26, me Kod Unik 2066004181, në Zonën Kadastrale 2066, Lloji i pasurisë: me sipërfaqe totale 10000 m², me adresë: Kamëz, në pronësi të Bashkisë Kamëz, për ndërtimin e banesave sociale.
2. Ndërtimi i banesave sociale, përfshin hartimin dhe miratimin e projektit të ndërtimit deri në përfundimin e tij dhe realizimin nga Bashkia Kamëz.
3. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të realizojë pasqyrimin e ndryshimeve në dokumentat e planifikimit vendor, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
4. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga fondi i përfituar sipas parashikimeve të nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, dhe nga vetë të ardhurat e Bashkisë Kamëz.
5. Për zbatim të ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve, Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit,
Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI**

